



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:045324
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05876667

P.nr.214/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gylaj Nepola, në çështjen penale kundër të pandehurit A (Z) B nga fsh. T, komuna Pejë, për shkak se ekziston dyshimi i bazuar mire se ka kryer vepër penale „Pëngimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare” nga neni 401 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm nën shenjën PP/IL.nr.450/21, të dt.09.03.2021, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit fillestar me datë 28.05.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore në Pejë Ermal Demhasaj, të pandehurit A.B, mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare av. Musa Haxhiu dhe të dëmtuarit N.B, me dt. 29.05.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 28.06.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

A.B, i njohur me nofkën “...”, nga i ati Z dhe nëna Sh e vajzërisë Sh, i lindur me datë në fsh. T Komuna Pejë, ku dhe banon, ka të kryer shkollën, i pa punë, i, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal, me nr. tel....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, dënuar më parë, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë rreth orës min, në fshatin P, K Pejë, pikërisht në lokalit „T.L”, i pandehuri me forcë tenton ta pengoj personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare në atë mënyrë që: në kohën dhe vendin e lartcekur pasi që policia hyn brenda me forcë për kontrolle ku ishin shumë persona, për ta i pandehuri fillon që me sjellje dhe fjalë fyese të i ofendon zyrtarët policor dhe ti nxit të tjerët që të mos i respektojnë urdhrat e zyrtarëve policor dhe pastaj i gjuan në tokë shishe të birrës, në ato momente zyrtarët policor i kërkojnë që të qetësohet dhe të del jashtë lokalit por i pandehuri fillon përsëri ti shaj dhe ofendoj zyrtarët policor me ç ‘rast ia shtyn

dorën të dëmtuarit zyrtarit policor N.B, duke i thënë se nuk dua të dal jashtë, dhe pastaj zyrtari policor e përdor forcën që ta largojnë jashtë lokalit, por i pandehuri reziston në mënyrë aktive me qëllim për të mos u larguar dhe pastaj arrestohet.

- me çka ka kryer veprë penale „Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare” nga neni 401 par.5 e lidhur me par.1 të KPRK-së,

Andaj, konform nenit 7, 38, 39, 40, 42, 69, 70, nenit 401 par.5 e lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe nenit 364, 365, 449, 452, 460 të KPPRK-së, gjykata të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME BURGIM

- në kohëzgjatje prej **1 (një) viti**, të cilin dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- I pandehuri obligohet të paguaj e shpenzimet e procedurës dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzetë euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.
- I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 20 € (njëzetë euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.
- Pala e dëmtuar N.B hoqi dorë nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë nën shenjën PP/II. nr.45/2021, të dt.09.3.2021, kundër të pandehurit A(Z) B nga fsh. T, Komuna Pejë, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale „Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare” nga neni 401 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Konform nenit 240 të KPRK-së, gjykata me datë 28.05.2024, mbajti shqyrtimin fillestar në praninë e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, të pandehurit A. B, mbrojtësit të tij av. Musa Haxhiu sipas detyrës zyrtare dhe të dëmtuarit N.B.

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 par.1 të KPPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurin në të drejtat e tij.

Pas leximit të aktakuzës, gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë konform dispozitës së nenit 241 par.4 të KPPRK-së.

I pandehuri i vetëdijshëm për natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, deklaroi se e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa presion.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë meqenëse pranimi i fajësisë ka mbështetje në prova të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, pas dëgjimit të palëve të cilët u pajtuan me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, e ka miratuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi është bindur se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 242 par. 2, nën par. 2.1, 2.3, 2.4 të KPPRK-së, pasi që i pandehuri e kuptoj natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: kallëzimi penal nr.2021-DA-247 dt.24.02.2021, raporti fillestar i incidentit 2021-DA-247 dt.18.02.2021, raporti i oficerit policor Muhamet Loxha dt.18.02.2021, raporti i oficerit policor Muhamet Loxha dt.18.02.2021, raporti i oficerit policor Nehat Bejta, raporti i oficerit policor Avni Hasani dt.18.02.2021, raporti i oficerit policor Ahmet Suhogërlla dt.18.02.2021 raporti i oficerit policor Sadat Kojiç dt.18.2.2021, dt.18.2.2021 dhe deklarata e të pandehurit e dhënë në polici me datë18.02.2021, Aktvendimi RLN.II.nr.53/2021,për ndalimin e personit të arrestuar procesverbali i të dëmtuarit N.B, 4.3.2021,procesverbali i dëshmitarit Avni Hasani dt.04.03.2021 dhe procesverbali i pandehurit A.B i dt. 09.03.2021.

Prokurori i shtetit lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit i propozoi gjykatës që pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese, ndërsa si rrethanë rënduese dënimet eventuale të mëparshme të të pandehurit.

I dëmtuari deklaroi se heq dorë nga kërkesa pasurore juridike, meqenëse me të pandehurin pas ngjarjes së ditës kritike nuk është takuar asnjëherë më.

Mbrojtësi i të pandehurit lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, i propozoi gjykatës që për të mbrojturin e tij pranimi i fajësisë të merret si rrethanë lehtësuese, ngase i mbrojturi i tij ditën kritike ishte i ndikuar nga emocionet dhe ishte nën ndikim të alkoolit. Po ashtu shtoi se i njëjti është penduar për veprimet e bëra, andaj i kërkoi gjykatës që të mbrojturit të tij ti shqiptohet një dënim sa më i butë.

I pandehuri deklaroi se pajtohet me fjalën e mbrojtësit të tij dhe shtoi se ndihet i penduar i propozoj gjykatës që lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit të merret si rrethane lehtësuese deklarata e tij mbi pranimin e fajësisë se dhe faktin se tash më me të dëmtuarën nuk ka kurrfarë kontakti.

Prandaj, me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale „Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ” nga neni 401 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë, i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjykata i ka vlerësuar te gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim te nenit 69 dhe 70 te KPRK-se. Si rrethana rënduese gjykata mori parasysh shkallën e lartë të dashjes, pasi që i njëjti përkundër paralajmërimit të zyrtarëve policor, vazhdon të qëndrojë në lokal dhe këmbëngulë në kryerjen e veprës penale, e po ashtu iu bën thirrje edhe personave tjerë të pranishëm që mos ti binden urdhrave të zyrtarëve policor. Gjykata nga evidenca penale gjeti që i njëjti është shpallur fajtor dhe është gjykuar dhe atë sipas aktgjykimit P.nr.280/2012 i formës së prerë me datë 19.06.2012 për vepër penale „Falsifikim i parasë” nga neni 244 të KPRK-së.

Kurse si rrethana lehtësuese për te pandehurin, gjykata mori pranimin e fajësisë dhe raportet e rregulluara me të dëmtuarin.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja respektivisht përsëritja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6, nenin 450, 452 par.1 të KPP-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në të cilat të pandehurit obligohen t'i paguajnë brenda afatit e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Gjykata duke vepruar konform nenit 460 të KPPRK-së, nuk e udhëzoi palën e dëmtuar në kontest civil, pasi i njëjti heqi dorë nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal
P.nr.214/21, me datë 28.06.2024

Bashkëpunëtore profesionale

Gjyqtare e vetme gjykuese

Gylaj Nepola

Ilda Cucović Sahatçiu

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykatë.